

RREGULLAT PËR SIGURI NË PUNË GJATË TRANSPORTIMIT, NGARKIMIT DHE SHKARKIMIT TË MALLRAVE PËR TRANSPORTIN RRUGOR

1. RREGULLAT E PËRGJITHSHME

- 1.1. Pas daljes nga kabina e automjetit motorik është e detyrueshme të përdoren veshje pune dhe pajisje mbrojtëse personale, sipas kërkesave të përmendura më poshtë në терминаlet e ngarkim-shkarkimit.
- 1.2. Të mos lejohet ndotja e mjedisit (ajrit, ujërave sipërfaqësore, ujërave nëntokësore dhe tokave) gjatë transportimit, ngarkimit dhe shkarkimit të ngarkesave.
- 1.3. Nuk lejohet përmbajtja e alkoolit 0 % në hyrje, gjatë qëndrimit në territorin dhe në dalje nga Aurubis Bullgari. Në prani të alkoolit mbi 0 % lëshohet protokoll FM-SRMD-014-B dhe shkelësit sanksionohen.
- 1.4. Të gjithë shoferët në territorin e Aurubis Bullgari janë të detyruar të lëvizin në itinerarin e caktuar sipas sinjalizimit vertikal rrugor, të përdorin dritat e ditës (të shkurtra), të përdorin rripat e sigurimit, të respektojnë tabelat e sinjalizimit vertikal, sinjalizimet horizontale, sinjalizimet e ndritshme dhe kufirin e shpejtësisë **30 km/orë**. Në rast të mosrespektimit të shpejtësisë së lëvizjes lëshohet protokoll FM-SRMD-015-B dhe shkelësit sanksionohen.
- 1.5. Të gjithë shoferët në territorin e Aurubis Bullgari detyrimisht duhet të respektojnë udhëzimet e personelit të Aurubis Bullgari dhe të kompanisë së sigurimit fizik.
- 1.6. Të gjitha automjetet motorike që hyjnë përmes Portalit Verior në Aurubis Bullgari, i nënshtrohen kontrollit radioaktiv. Në rast të sinjalizimit të vazhdueshëm të alarmit, automjeti orientohet në parkingun pranë GPP (Nënstacionit kryesor elektrik) №2 për një kontroll vijues të radiacionit.
- 1.7. Gjatë punimeve të ngarkim-shkarkimit automjetet, përfshirë gjysmërimorkiot dhe rimorkiot, duhet të sigurohen nga shoferi me anën e pykave të vendosura mbi rrotat e boshtit të pasmë.
- 1.8. Në rast se parashikohet që shoferi të marrë pjesë në punimet e ngarkim-shkarkimit **në zonën prodhuese jashtë terminaleve të përmendura më poshtë** ai duhet të jetë pajisur me mjetet përkatëse të sigurimit dhe me veshje pune, të cilat duhet të përdoren dhe janë të specifikuara me shenjë përpara hyrjes në këtë zonë.
- 1.9. Ndalohet prania e shoferit ose e njerëzve të tjerë në rimorkio, si dhe në distancë më pak se 5 m nga automjeti gjatë ngarkimit/shkarkimit.
- 1.10. Në territorin e Aurubis Bullgari **fotografimi dhe video incizimi janë të ndaluara**. Mund të bëhen vetëm pas lejes së posaçme me shkrim. Shkelësit sanksionohen.
- 1.11. Gjatë qëndrimit në territorin e Aurubis Bullgari midis peshimit bruto dhe tara, përkatësisht tara dhe bruto, ndalohet kryerja e aktiviteteve (si hedhja/ ngritja e objekteve, kullimi/shtimi i lëngjeve etj.) që mund të ndikojnë në matjen e peshoreve të automjeteve.
- 1.12. Nuk lejohet dëmtimi, çmontimi dhe shkyçja e komponentëve nga sistemet e kontrollit të aksesit, mbikëqyrjes me video dhe teknikës sinjalizuese të sigurisë.

2. DOKUMENTIMI I INSTRUKTIMIT FILLESTAR

- 2.1. Instruktimi fillestar i shoferit dokumentohet me nënshkrimin e tij në librin e instruktimit fillestar. Personat që kanë kaluar instruktimin fillestar pajisen me një kartë të përherëshme për hyrje të drejtuesve të automjeteve motorike në rast se kryejnë veprimtari të përherëshme të ngarkim-shkarkimit në territorin e Aurubis Bullgari. Me karta të përkohshme për hyrje pajisen drejtuesit e automjeteve motorike, të cilët kryejnë veprimtari të njëhershme të ngarkim-shkarkimit në zona të punës dhe në terminale.
- 2.2. Karta e përkohshme lëshohet gjatë vizitës së parë në Aurubis Bullgari, pas njohjes dhe marrjes së OD-HNSD-001-B Rregullat për siguri në punë gjatë transportimit, ngarkimit dhe shkarkimit të ngarkesave për transportin rrugor (Rregullat) dhe i jepet drejtuesit të automjetit motorik dhe në dalje karta e përkohshme kthehet rojës në Portalin Verior.

- 2.3. Gjatë hyrjes tjetër të të njëjtit shofer nuk kërkohet lëshimi i kartës së re.
- 2.4. Kur Rregullat ndryshohen secili drejtues i automjetit motorik detyrimisht i nënshtrohet instruktimit fillestar.

3. SANKSIONET

- 3.1. Në rast të mosrespektimit të kërkesave të mësipërme lëshohet një formular për shkelje FM-HNSD-028-B dhe protokoll për sanksionim FM-PROC-014-B.
- 3.2. **Personeli i kompanive të jashtme dhe furnizuesve të jashtëm** që kanë marrëdhënie kontraktore me Aurubis Bullgari gjobiten me 200 leva.
Për pikën 1.3; pikën 1.4 dhe pikën 1.12 jepen sanksione sipas Urdhrave të Drejtorit Ekzekutiv të Aurubis Bullgari.
- 3.3. Në rast të shkeljes së dytë të rregullave për sigurinë dhe shëndetin në punë dhe mbrojtjen e mjedisit **nga i njëjti person brenda 1 viti**, personi largohet nga sheshi i punës dhe privohet nga e drejta e hyrjes në territorin e Aurubis Bullgari për një periudhë 1 vjeçare.

4. PAJISJET MBROJTËSE PERSONALE TË DETYRUESHME, VESHJET E PUNËS DHE RREGULLAT SPECIFIKE PËR NGARKIM-SHKARKIM NË TERMINAL

№ i terminalit:	ZONA:
A	DREJTIMI METALURGJI
A1	Terminal për shkarkimin e kamionëve në magazinën “Skrap- anodë dhe koks”
A2	Terminal „Kardox” - seksioni „Shkrirje“, rrugë № 39 (ashensor mallrash), ADR
A3	Terminal për shkarkimin e azotit (në veri të “Pastrimit të gazit”), ADR
A4	Terminal për shkarkimin e kamionëve në magazinën „Skrap bakri“
A5	Terminal për shkarkimin e kamionëve vetëshkarkues automatik në magazinën „Koncentrate bakri“
A6	Terminal për shkarkimin e kamionëve në Përzierjet parësore (shihtën) (rërë dhe koncentrat ari)
A7	Terminal për shkarkimin e hidroksidit të natriumit, rrugë № 63 (XBO – Pastrimi kimik i ujit), ADR
A8	Terminal për shkarkimin e kamionëve me gëlqere të pashuar, ADR
Veshje pune dhe pajisje mbrojtëse personale (VP dhe PMP)	1.Veshje pune, xhaketë dhe kominoshe me rripa ose kominoshe, ose pantallona– sipas SSHB (Standardit shtetëror bullgar) EN 13688:2013 * me përjashtim të: Terminalit A2 - Veshje pune, xhaketë dhe kominoshe me rripa ose kominoshe, ose pantallona (antistatike) – sipas SSHB EN 1149-1:2006 * me përjashtim të: Terminalit A7 - Veshje pune, xhaketë dhe kominoshe me rripa ose kominoshe, ose pantallona (rezistente ndaj acideve) – sipas SSHB 11665-73 2. Këpucë pune me majë mbrojtëse dhe taban anti-shpim – sipas SSHB EN 20345:2011 S3 3. Jelek reflektues / Veshje pune reflektuese 4. Helmetë sigurie, me rezistencë ndaj goditjeve dhe rrymës elektrike – sipas SSHB EN 397:2012 + SSHB EN 50365:2003 5. Gjysmë-maskë me filtër ABE1P3 – sipas SSHB EN 14387:2004+A1:2008 + SSHB EN 143:2002 6. Syze sigurie për mbrojtje mekanike – sipas SSHB EN 166:2003 1FT * me përjashtim të: Terminalit A7 – Syze sigurie (të tipit të mbyllur) – sipas SSHB EN 166:2003 1BT ose mburojë sigurie për fytyrën (transparente) sipas SSHB EN 166:2003 7. Doreza sigurie me mbrojtje mekanike – sipas SSHB EN 388:2016 * me përjashtim të: Terminalit A2 – Doreza sigurie (antistatike) – sipas EN 16350:2014 * me përjashtim të: Terminalit A7 – Doreza sigurie me mbrojtje kimike – sipas SSHB EN 374:2015
Terminal	RREGULLAT SPECIFIKE PËR NGARKIM/SHKARKIM
A2	Terminal „Kardox” – seksioni „Shkrirje”, rrugë № 39 (pranë ashensorit të mallrave), ADR
	Shkarkimi i gazit natyror të kompresuar (Metan), ADR 1. Koordinuesi për veprimtaritë e shpërthimit dhe furrën e shkrirjes ose Koordinuesi për kazanin e ripërdorimit, ndalon pajisjet nën presion, zbraz sistemin dhe përgatit grupin e bombolave për shfrytëzim duke fikur lidhjen e shpejtë të zorrës me pakon e bombolave. 2. Drejtuesi tokëzon me një kablo të rregullt të tokëzimit të automjetit të specializuar duke e lidhur pllakën e automjetit të specializuar të transportit me tokëzuesin e stacionit të metanit. 3. Të gjitha veprimet e drejtuesit të automjetit të specializuar të transportit kryhen nën kontrollin direkt të Koordinuesit të punimeve të shpërthimit dhe të furrës së shkrirjes ose të Koordinuesit për kazanin e ripërdorimit.

A4	Terminal për shkarkimin e kamionëve në magazinën “Skrup bakri”
	1. Drejtuesi e parkon automjetin motorik në sheshin në lindje të magazinës “Skrup bakri”. 2. Sipas udhëzimit të Kontrolluesit të vjetër të cilësisë/ Kontrolluesit të cilësisë së produkteve të ricikluara automjeti futet në magazinë dhe shkarkohet në vendin e caktuar. 3. Pas shkarkimit të mbeturinave të bakrit drejtuesi pastron automjetin në magazinë dhe largohet nga territori i firmës.
A5	Terminal për shkarkimin e kamionëve vetëshkarkues automatik në magazinën “Koncentrate bakri”
	1. Drejtuesi shkarkon automjetin në bunkerin e treguar /sipas udhëzimit të Mjeshtrit të vjetër, në rast nevojë/. 2. Nuk lejohet përdorimi i kamionëve pa dyer të pasme /kapakë të pasme dhe tenda. 3. Koshi i kamionit zbritet kur kamioni është i pozicionuar përpara bunkerit dhe menjëherë pas pastrimit me lopatëz të vendit të caktuar. Nuk lejohet lëvizja e kamionit me koshin e ngritur! 4. Gjatë muajve të ngrohtë pas pastrimit kamioni detyrimisht lahet në lavazh.
A7	Terminal për shkarkimin e hidroksidit të natriumit, rrugë № 63 (XBO-Pastrimi kimik i ujit), ADR
	1. Shoferi e pozicionon autobotin kështu që zorra prej tij deri në valvulën thithëse të pompës të jetë vendosur pa kthesë. 2. Operatori i instalimit të përgatitjes së ujit e lidh zorrën nga autoboti me rakorderin e valvulës thithëse të pompës për shkarkim dhe ndez pompën, pas kësaj shoferi hap valvulën e autobotit. 3. Pas shkarkimit të tërë sasisë shoferi mbyll valvulën e autobotit. Pompa lihet në punë dhe në atë kohë operatori mbyll valvulën e linjës thithëse dhe më në fund fiket vet pompa. 4. Pas mbarimit të shkarkimit shoferi demonton me kujdes zorrën dhe largohet nga vendi i shkarkimit. 5. Operatori i Instalimit të përgatitjes së ujit detyrimisht duhet të kullojë linjën e shkarkimit /në enët e përgatitura për këtë qëllim/ për të evituar kristalizimin e NaOH brenda tubave dhe valvulave. Valvulat mbeten të hapura. 6. Sheshi lahet dhe ujërat e ndotura largohen në kanalizimin për aciditet.
A8	Terminal për shkarkimin e kamionëve me gëlqere të pashuar, ADR
	1. Drejtuesi e parkon automjetin motorik në sheshin e shkarkimit dhe pret udhëzimet e Shefit të turnit Metalurgji. 2. Nëse ka gëlqere të pashuar të shpërndare rreth kamionit, përpara largimit shoferi e pastron. Inspekton me kujdes rreth kapakut të pasme që të mos ketë gunga të gëlqeres së pashuar.
B	PRODIMI I ACIDIT TË SQUFURIT
B1	Terminal i furnizimit të naftës/gazoilit , ADR
B2	Terminal i furnizimit të qelqit të lëngshëm, seksioni i larjes, linja e parë
B3	Terminal i furnizimit të qelqit të lëngshëm, seksioni i larjes, linja e dytë
B4	Terminal i ngarkimit të acidit të sqfurit, ngarkesa të vogla, ADR

VP dhe PMP	1. Veshje pune, xhaketë dhe kominoshe me rripa ose kominoshe, ose pantallona (rezistente ndaj acideve) – sipas SSHB EN 13688:2013 dhe SSHB 11665-73 * me përjashtim të: Terminalit B1 - Veshje pune, xhaketë dhe kominoshe me rripa ose kominoshe, ose pantallona (rezistente ndaj acideve dhe antistatike) – sipas SSHB 11665-73 + SSHB EN 1149-1:2006 2. Këpuce pune me majë mbrojtëse dhe taban anti-shpim – sipas SSHB EN 20345:2011 S3 3. Jelek reflektues / Veshje pune reflektuese 4. Helmetë sigurie, me rezistencë ndaj goditjeve dhe rrymës elektrike– sipas SSHB EN 397:2012 + SSHB EN 50365:2003 5. Gjysmë-maskë me filtër ABE1P3 - sipas SSHB EN 14387:2004+A1:2008 + SSHB EN 143:2002 6. Syze sigurie me mbrojtje mekanike– sipas SSHB EN 166:2003 1FT * me përjashtim të: Terminalit B1 dhe Terminalit B4 - Syze sigurie (të tipit të mbyllur) – sipas SSHB EN 166:2003 1BT ose mburojë sigurie për fytyrën (transparente) sipas SSHB EN 166:2003 7. Doreza sigurie me mbrojtje mekanike dhe kimike – sipas SSHB EN 388:2016 + SSHB EN 374:2015
Terminal	RREGULLAT SPECIFIKE PËR NGARKIM/SHKARKIM
B1	Terminal i furnizimit të naftës/gazolit, ADR 1. Shoferi del nga kabina i pajisur detyrimisht me veshjen e punës dhe me pajisjet mbrojtëse personale të përmendur më lartë. 2. Tokëzon autobotin me një kablo të rregullt të tokëzimit duke e lidhur pllakën e automjetit të specializuar të transportit me tokëzuesin pranë stacionit të naftës. 3. Shoferi i autobotit pret që Operatori i nivelit të I në (PSK) (Prodhimi i acidit të squfurit) të vijë në vend për përgatitjen e shkarkimit. 4. Operatori i nivelit të I në PSK shkyç drynin në vendin e bashkimit. 5. Shoferi e bashkon lidhjen fleksibël nga kamioni me sistemin e shkarkimit. 6. Operatori i nivelit të I në PSK vë në punë pompën e shkarkimit. 7. Shoferi i kamionit pret në kabinë procesin e shkarkimit dhe pret që Operatori i nivelit të I në PSK të ndalojë pompën. 8. Shoferi demonton lidhjen fleksibël dhe e fut në kamion. 9. Shoferi i dorëzon të gjitha dokumentet e nevojshme Operatorit të nivelit të I - ADD (dokumenti tatimor i akcizës), Fletëngarkesën, Certifikatën e cilësisë, Protokollin për markimin e naftës etj. 10. Shoferi largohet nga sheshi dhe e çon autobotin për matje në peshoren e automjeteve.
B2, B3	Terminal për furnizim të qelqit të lëngshëm, seksioni i larjes, linja e I/ II 1. Shoferi del nga kabina i veshur detyrimisht me veshjen e punës dhe pajisjet mbrojtëse personale, të përmendura më lart. 2. Në rast nevojë për të hipur në autobot shoferi sigurohet me mjete mbrojtëse kolektive ose personale kundër rënies nga lartësia 3. Shoferi i autobotit pret që Operatori i nivelit të I në PSK të vijë në vend për përgatitjen e shkarkimit. 4. Operatori i nivelit të I në PSK i tregon shoferit vendin për bashkimin e lidhjes fleksibël. 5. Shoferi e bashkon lidhjen fleksibël nga kamioni me sistemin e shkarkimit.

	6. Operatori i nivelit të I në PSK vë në punë pompën për shkarkimin e qelqit të lëngshëm në rezervuarin marrës. 7. Shoferi i kamionit pret procesin e shkarkimit dhe pret që Operatori i nivelit të I në PSK të ndalojë pompën. 8. Shoferi demonton lidhjen fleksibël detyrimisht në praninë e Operatorit të nivelit të I dhe e fut në kamion. 9. Ndalohet kullimi i zorrës nëse nuk është treguar një vend i caktuar për këtë nga Operatori i nivelit të I, nëse ka nevojë për kullim. 10. Shoferi i dorëzon të gjitha dokumentet e nevojshme Operatorit të nivelit të I - Fletëngarkesën, Certifikatën e cilësisë, Protokollin për dorëzim-marrjen e qelqit të lëngshëm. 11. Shoferi largohet nga sheshi dhe e çon autobotin për matje në peshoren e automjeteve.
B4	Terminal për furnizimin e acidit të squfurit, ngarkesa të vogla, ADR 1. Shoferi del nga kabina i veshur detyrimisht me veshjen e punës dhe pajisjet mbrojtëse personale, të përmendura më lart. 2. Gjatë hapjes së kapakut për mbushjen e autobotit sigurohet me mjete mbrojtëse kolektive ose personale kundër rënies nga lartësia 3. Shoferi pozicionin autobotin nën tubin për mbushje. 4. Gjatë mbushjes së autobotit ai largohet nga sheshi. 5. Shoferi pret që Operatori PSK ta lajmërojë se autoboti është mbushur. 6. Operatori PAK i jep shoferit vula për t'i vërë në kapakun/ët e autobotit dhe dokumentet e nevojshme të spedicionit - urdhrin e spedicionit dhe certifikatën e cilësisë. 7. Pas kësaj shoferi shkon në parkingun e veçuar. 8. Shoferi mbyll kapakun/kapakët e autobotit duke u siguruar me pajisjet kolektive ose personale mbrojtëse kundër rënies nga lartësia. 9. Shoferi largohet nga sheshi dhe e çon autobotin për matje në peshoren e automjeteve. 10. Ndalohet rreptësisht qëndrimi i shoferi rreth ose brenda kabinës së kamionit gjatë mbushjes së autobotit me acid.
C	DREJTIMI RAFINERI
C1	Terminal për ngarkimin e kamionëve me bakër katodë
C2	Terminal për ngarkimin e kamionëve me murgë anodë, ADR
C3	Terminal për ngarkimin e kamionëve me sulfat nikeli, ADR
VP dhe PMP	1. Veshje pune, xhaketë dhe kominoshe me rripa ose kominoshe, ose pantallona – sipas SSHB EN 13688:2013 2. Këpucë pune me majë mbrojtëse dhe taban anti-shpim – sipas SSHB EN 20345:2011 S3 3. Jelek reflektues / Veshje pune reflektuese 4. Helmetë sigurie, me rezistencë ndaj goditjeve dhe rrymës elektrike – sipas SSHB EN 397:2012 + SSHB EN 50365:2003 5. Syze sigurie me mbrojtje mekanike – sipas SSHB EN 166:2003 1FT 1FT
Terminal	RREGULLAT SPECIFIKE PËR NGARKIM/SHKARKIM
C1	Terminal për ngarkimin e kamionëve me bakër katodë

	1. Karrocera e automjetit të jetë e pastër. 2. Hyrja për në sheshin verior të Rafinerisë bëhet përmes hyrjes juglindore. 3. Heqja e tendave të automjetit bëhet përpara sheshit të ngarkimit dhe shoferi përdor pajisje personale mbrojtëse. 4. Pas pozicionimit për ngarkim fiket motori i mjetit. 5. Shoferi cakton vendet për pozicionimin e pakove në rimorkio. 6. Ndalohet qëndrimi i drejtuesit ose njerëzve të tjerë në rimorkio si dhe në distancë së paku 5 metra nga automjeti gjatë ngarkimit të pakove me bakrin katodë. 7. Pas ngarkimit drejtuesi mund të hipë në rimorkio dhe të kontrollojë a janë të respektuar vendet e caktuara prej tij për vendosjen e pakove dhe të kërkojë, në rast nevojë, spostimin e ngarkesës. 8. Drejtuesi e siguron ngarkesën me rripa përforcues. 9. Shoferi e çon automjetin e ngarkuar në pjesën perëndimore të sheshit për përpunimin dhe përgatitjen e dokumenteve. 10. Vendosja e tendave në rimorkio dhe vulosja. 11. Ndalohet hyrja në zyrën e Magazinës. 12. Ndalohet pirja e duhanit në sheshin e ngarkimit. 13. Dalja e automjetit të ngarkuar bëhet përmes barrierës veriperëndimore të sheshit.
C2, C3	Terminal për ngarkimin e kamionëve me murgë anodë, ADR, Terminal për ngarkimin e kamionëve me sulfat nikeli, ADR 1. Automjeti duhet të jetë pajisur me një numër të caktuar të rripave përforcues me qëllim sigurimin e ngarkesës gjatë transportimit të saj tek klienti. 2. Automjeti duhet të jetë i pajisur me numrin e nevojshëm të kufizues metalikë me qëllim sigurimin e ngarkesës gjatë transportimit të saj tek klienti. 3. Drejtuesi përgjigjet për vendosjen e rripave dhe kufizuesve metalikë përforcues. 4. Karrocera e automjetit duhet të jetë e pastër.
D	DREJTIMI FABRIKA E PASURIMIT
D1	Terminal për shkarkimin e ksantogjenatit izobutil të kaliumit, ADR
D2	Terminal për ngarkimin e kamionëve me fajalit
VP dhe PMP	1. Veshje pune, xhaketë dhe kominoshe me rripa ose kominoshe, ose pantallona – sipas SSHB EN 13688:2013 2. Këpucë pune me majë mbrojtëse dhe taban anti-shpim – sipas SSHB EN 20345:2011 S3 3. Jelek reflektues / Veshje pune reflektuese 4. Helmetë sigurie, me rezistencë ndaj goditjeve dhe rrymës elektrike – sipas SSHB EN 397:2012 + SSHB EN 50365:2003 5. Gjysmë-maskë me filtër ABE1P3 – sipas SSHB EN 14387:2004+A1:2008 + SSHB EN 143:2002 6. Syze sigurie me mbrojtje mekanike – sipas SSHB EN 166:2003 1FT 7. Doreza sigurie me mbrojtje mekanike dhe kimike – sipas SSHB EN 388:2016 + SSHB EN 374:2015

Terminal	RREGULLAT SPECIFIKE PËR NGARKIM/SHKARKIM
D1	Terminal për shkarkimin e ksantogjenatit izobutil të kaliumit, ADR
	1. Kur mbërrin në drejtimin Fabrika e pasurimit drejtuesi pret udhëzimet e Shefit të turnit për ngarkim/shkarkim në parkingun përpara Godinës administrative. 2. Hiqet mbulesa e automjetit menjëherë përpara ngarkimit. Kthimi i saj bëhet pas ngarkimit në sheshin e ngarkimit. 3. Pas pozicionimit për ngarkim fiket motori i automjetit. 4. Nëse rrugët nuk janë të lagështa lëvizja e automjeteve motorike pezullohet.
D2	Terminal për ngarkimin e kamionëve me fajalit
	1. Shoferi përgjigjet që sektori i ngarkimit të kamionit vetëshkarkues automatik të jetë i pastër. 2. Shoferin cakton vendet për pozicionimin e ngarkesës në rimorkion/koshin e kamionit vetëshkarkues automatik. 3. Nuk lejohet përdorimi i kamionëve pa kapakë të pasmë dhe pa tenda. 4. Nëse rrugët nuk janë të lagështa lëvizja e automjeteve motorike pezullohet.
E	Pastrimi i ujërave /PV/
E1	Terminal për shkarkimin e kamionëve me gëlqere të pashuar në PV, ADR
E2	Terminal për shkarkimin e kamionëve me feriklorid në PV, ADR
E3	Terminal për shkarkimin e kamionëve me acid klorhidrik në PV, ADR
E4	Terminal për shkarkimin e peroksid hidrogjenit në PV, ADR
E5	Terminal për shkarkimin e kamionëve me feriklorid, ADR /acid squfuri/, ADR /gëlqere e hidratuar/ në PSDV /Stacioni i pastrimit të ujit të reshjeve/
VP dhe PMP	1. Veshje pune, xhaketë dhe kominoshe me rripa ose kominoshe, ose pantallona (me rezistencë ndaj acideve)– sipas SSHB EN 13688:2013 + SSHB 11665-73 2. Këpucë pune me majë mbrojtëse dhe taban anti-shpim – sipas SSHB EN 20345:2011 S3 3. Jelek reflektues / Veshje pune reflektuese 4. Helmetë sigurie, me rezistencë ndaj goditjeve dhe rrymës elektrike– sipas SSHB EN 50365:2003 5. Gjysmë-maskë me filtër ABE1P3 – sipas SSHB EN 14387:2004+A1:2008 + SSHB EN 143:2002 6. Syze sigurie për mbrojtje mekanike– sipas SSHB EN 166:1FT * me përjashtim të: Terminalit E2 – Syze sigurie të tipit të mbyllur) SSHB EN 166:2003 1BT ose mburojë sigurie për fytyrën (transparente) SSHB EN 166:2003 * me përjashtim të: Terminalit E5 – feriklorid/ acid squfuri - Syze sigurie të tipit të mbyllur) SSHB EN 166:2003 1BT ose mburojë sigurie për fytyrën (transparente) SSHB EN 166:2003 7. Doreza sigurie me mbrojtje mekanike dhe kimike- sipas SSHB EN 388:2016 + SSHB EN 374:2015
Terminal	RREGULLAT SPECIFIKE PËR NGARKIM/SHKARKIM
E1	Terminal për shkarkimin e kamionëve me gëlqere të pashuar në PV, ADR
	1. Drejtuesi e parkon automjetin motorik në sheshin e shkarkimit dhe pret udhëzimet e Operatorit të Proceseve kimike. 2. Pas derdhjes së gëlqeres së pashuar në bunker dhe fillimit të shkarkimit, shoferi nuk largohet nga sheshi i shkarkimit pa lejen e Operatorit.

	3. Në se ka gëlqere të pashuar të shpërndarë rreth kamionit përpara nisjes shoferi e pastron. Inspekton me kujdes rreth kapakut të pasmë që të mos ketë gunga gëlqereje.
E2	Terminal për shkarkimin e kamionëve me feriklorid në PV, ADR 1. Shoferi parkon automjetin motorik në sheshin e shkarkimit pranë rezervuarëve dhe pret udhëzimet e Operatorit të proceseve kimike. 2. Lidh me kujdes zorrën me rakordin përmes të cilit shkarkohet ferikloridi, duke kontrolluar tërësinë e të gjitha elementeve lidhëse. 3. Pas përfundimit të shkarkimit drejtuesi demonton me kujdes zorrën dhe ndjek të mos shkaktohet derdhje e ferikloridit të mbetur në të, deri sa të pozicionohet në gropën e rezervuarëve. Largohet nga vendi i shkarkimit kur është i bindur, se nuk ka derdhje të ferikloridit nga autoboti ose nga rakordi i shkarkimit në shesh.
E3	Terminal për shkarkimin e kamionëve me acid klorhidrik në PV, ADR 1. Shoferi parkon automjetin motorik në sheshin e shkarkimit pranë rezervuarit dhe pret udhëzimet e Operatorit të proceseve kimike. 2. Lidh me kujdes zorrën me rakordin përmes të cilit shkarkohet acidi klorhidrik pasi ka kontrolluar paraprakisht tërësinë e të gjitha elementeve lidhëse. 3. Pas përfundimit të shkarkimit drejtuesi demonton me kujdes zorrën dhe ndjek të mos shkaktohet derdhje e acidit klorhidrik të mbetur në të, deri sa të pozicionohet në gropën e rezervuarëve. Largohet nga vendi i shkarkimit kur është i bindur, se nuk ka derdhje të acidit klorhidrik nga autoboti ose nga rakordi i shkarkimit në shesh.
E5	Terminal për shkarkimin e kamionëve me gëlqere të hidratuar në PSDV 1. Shoferi parkon automjetin motorik në sheshin e shkarkimit pranë rezervuarit dhe pret udhëzimet e Operatorit të proceseve kimike. 2. Lidh me kujdes zorrën shkarkuese të kamionit me rakordin e rezervuarit 3. Përmes punës së motorit të kamionit mban presionin në autobot në nivelin e përshtatshëm për shkarkim. Sipas udhëzimeve të Operatorit të proceseve kimike ky proces mund të ndërpritet dhe rifillohet disa herë. 4. Pas përfundimit të shkarkimit shoferi demonton me kujdes lidhjen. Niset kur sigurohet, se nuk do të ndotë rrugët dhe sheshet me gëlqere të hidratuar.
E5	Terminal për shkarkimin e kamionëve me feriklorid, ADR /acid squfuri, ADR në PSDV 1. Shoferi parkon automjetin motorik në sheshin e shkarkimit pranë rezervuarit dhe pret udhëzimet e Operatorit të proceseve kimike. 2. Lidh me kujdes zorrën me rakordin përmes të cilit shkarkohet ferikloridi/ acidi i squfurit , duke kontrolluar tërësinë e të gjitha elementeve lidhëse. 3. Pas përfundimit të shkarkimit shoferi demonton me kujdes zorrën duke ndjekur të mos shkaktohet derdhje e acidit të ferikloridit të mbetur në të deri sa të pozicionohet në kotlovanën e rezervuarëve. Largohet nga vendi i shkarkimit kur sigurohet, se nuk ka derdhje nga autoboti ose nga rakordi i shkarkimit në shesh.
F	EKONOMIA MAGAZINA
F1	Terminal për shkarkimin e pjesëve të ndërrimit, materialeve dhe artikujve të ndryshëm në Magazinën qendrore
F2	Terminal për shkarkim në magazinën “Ndërtim” dhe magazinën “Hekurishte”
F3	Terminal për shkarkim në magazinën “Investime”
F4	Terminal për shkarkim në magazinën „Investime” /DIK“

VP dhe PMP	1. Veshje pune, xhaketë dhe kominoshe me rripa ose kominoshe, ose pantallona (me rezistencë ndaj acideve)– sipas SSHB EN 13688:2013 2. Këpucë pune me majë mbrojtëse dhe taban anti-shpim – sipas SSHB EN 20345:2011 S3 3. Jelek reflektues / Veshje pune reflektuese 4. Helmetë sigurie, me rezistencë ndaj goditjeve dhe rrymës elektrike– sipas SSHB EN 50365:2003 5. Syze sigurie për mbrojtje mekanike– sipas SSHB EN 166:1FT 6. Doreza sigurie me mbrojtjes mekanikë SSHB EN 388:2016
Terminal	RREGULLAT SPECIFIKE PËR NGARKIM/SHKARKIM
F1, F2, F3, F4	Terminal për shkarkimin e pjesëve ndërrimi, materialeve dhe artikujve ë ndryshëm në Magazinën qendrore, terminal për shkarkimin në magazinën “Ndërtim” dhe magazinën “Hekurishte”, terminal për shkarkimin në magazinën “Investime” dhe terminal për shkarkimin në magazinën “DIK Investime”
	1. Me mbërritjen në terminalin përkatës, drejtuesi i automjetit pret instruksionet për shkarkimin sipas udhëzimeve të Punëtorit që shërben në Ekonominë Magazina dhe/ose të Specialistit të Blerjeve operative dhe Administratës së magazinave. 2. Pas pozicionimit për shkarkim drejtuesi i automjetit me pajisjet përkatëse mbrojtëse të përmendura më lartë fik motorin e mjetit, zbulon rimorkion dhe liron rripat përforcuese të ngarkesës. 3. Drejtuesi i automjetit është i detyruar të respektojë kërkesat për punimet e ngarkim-shkarkimit, sipas specifikimit të materialeve të furnizuara. 4. Ndalohet pirja e duhanit në sheshin për ngarkim, pirja e duhanit lejohet vetëm në vendet e posaçme të caktuara për këtë qëllim. 5. Ndalohet hyrja në zyrat e ekonomisë Magazina. 6. Përpunimi dhe/ose përgatitja e dokumenteve bëhet vetëm në vendet posaçërisht të caktuara për këtë. 7. Pas shkarkimit drejtuesi automjetit mbyll rimorkion dhe largohet nga sheshi për ngarkim.
G	MBARTËSITË E ENERGJISË ELEKTRIKE
G1	Terminal për shkarkimin e gazit të lëngshëm „Propan-butan“ – magazina „Propan-butan“,ADR
G2	Terminal për shkarkimin e lubrifikanteve të paketuara – ekonomia “Mazut”
G3	Terminal për shkarkimin e naftës/gazoilut – Stacioni i kaldajës së avullit, ADR
VP dhe PMP	1. Veshje pune, xhaketë dhe kominoshe me rripa ose kominoshe, ose pantallona (antistatike)– sipas SSHB EN 11149-1:2006 * me përjashtim të: Terminalit G2 - Veshje pune, xhaketë dhe kominoshe me rripa ose kominoshe, ose pantallona – sipas SSHB EN 13688:2013 2. Këpucë pune me majë mbrojtëse dhe taban anti-shpim – sipas SSHB EN 20345:2011 S3 3. Jelek reflektues / Veshje pune reflektuese 4. Helmetë sigurie, me rezistencë ndaj goditjeve dhe rrymës elektrike– sipas SSHB EN 397:2012 + SSGB EN 50365:2003 5. Syze sigurie me mbrojtje mekanike– sipas SSHB EN 166:1FT * me përjashtim të: Terminalit G2 – Syze sigurie me mbrojtje mekanike dhe kimike – sipas SSHB EN 166:2003 1FT – në rast nevojë 6. Doreza sigurie – antistatike (mbrojtje mekanike) – sipas SSHB EN 388:2016 EN 16350:2014

	* me përjashtim të: Terminalit G2 – Doreza sigurie me mbrojtje mekanike – sipas SSHB EN 388:2016
TERMINAL	RREGULLAT SPECIFIKE PËR NGARKIM/SHKARKIM
G1	Terminal për shkarkimin e gazit të lëngshëm „Propan-butan“ – Magazina „Propan-butan“, ADR 1. Të gjitha veprimet e drejtuesit të automjetit për shkarkimin e gazit propan-butan kryhen nën kontrollin e drejtpërdrejtë të Montuesit, operatorit të pajisjeve energjetike. 2. Tokëzimi bëhet me një kabllo vertikale tokëzuese të autobotit, duke e lidhur vendin përkatës/pllakën autobotit me tokëzuesin. 3. Demontohen flanxhat e shurdhër për fazën e gazit dhe për fazën e lëngshme të autobotit me çelësin përkatës, i cili të jetë i siguruar kundër shkëndijave. 4. Zorrët lëvizëse për fazën e gazit dhe për fazën e lëngshme lidhen me kujdes me flanxhat përkatëse të autobotit.. 5. Valvulat për fazën e gazit dhe fazën e lëngshme të autobotit që shkarkohet hapen ngadalë. 6. Pas përfundimit të shkarkimit, ngadalë mbyllen rubinetet sferike të linjës për mbushje dhe të fazës së gazit. 7. Mbyllen valvulat për gaz dhe fazën e lëngshme të autobotit për shkarkim.. 8. Presioni i zorrëve nga valvulat e kullimit zvogëlohet dhe demontohen nga autoboti. 9. Montohen flanxhat e shurdhër të autobotit me instrumentin e siguruar dhe të nevojshëm. 10. Pas ajrosjes natyrale të sheshit kabllo të tokëzimit shkëputen dhe hiqen. 11. Pas ajrosjes së sheshit autoboti nxirret nga magazina dhe çohet për matje në peshoren e automjeteve. 12. Shoferi dorëzon në zyrën e Lëndëve të para të energjisë elektrike dokumentet e nevojshme që shoqërojnë ngarkesën dhe merr verifikim të Dokumentit tatimor të akcizës.
G2	Terminal për shkarkimin e lubrifikanteve të paketuara – Ekonomia Mazut 1. Shkarkimi i lubrifikanteve të paketuara nga automjetet – kamion dhe mikrobuse në rampë dhe depozitimi i tyre në vende të ndryshme sipas tipave , bëhet nga Montuesi, Operator i pajisjeve energjetike me ndihmën e: - karrocës me platformë për kova dhe kuti kartoni me shishe - karrocës për fuçi - deri në 400 kg: ➤ dy dhëmbët e poshtëm kapës të karrocës së magazinës vihen shumë afër skajit të poshtëm të fuçisë ➤ gishti i sipërm kapës fiksohet në skajin e sipërm të fuçisë ➤ me anën e dorezave, karroca përkulet mbrapa dhe fuçia transportohet në vendin e caktuar ➤ kur arrin në vendin e depozitimit, karroca përkulet përpara, duke lëshuar gishtin e sipërm kapës dhe tërhiqet nga nën fuçia. - ngritës për së larti për fuçi, që drejtohet me dorë: ➤ gishti i sipërm kapës fiksohet në skajin e sipërm të fuçisë ➤ përmes pedalit ose dorezës fuçia ngrihet lehtë dhe me shtypjen e dorezës të poshtë vihet dhe gishti i poshtëm mbajtës ➤ fuçia është gati për transportim dhe përmes pedalit ose dorezës caktohet lartësia e nevojshme ➤ duke përdorur vidhën anësore, përmes rrotullimit të rrotës manuale

	djathtas, fuçia mund të pozicionohet edhe horizontalisht ose me pjerrësinë e nevojshme ➤ lëshimi i fuçisë bëhet me renditjen e anasjelltas. - ngritës për së larti për paleta të magazinimit që drejtohet me dorë ➤ me shtytje rrotat drejtuese vihen për së gjati nën paletë водещите полки, чрез прибутване, се поставят надлъжно под палето ➤ përmes pedalit ose dorezës paleta ngrihet lehtë dhe është gati për transportim ➤ duke përdorur pedalin dhe dorezën përcaktohet lartësia e nevojshme ➤ lëshimi i paletës bëhet duke ndjekur hapat anasjelltas.
G3	Terminal për shkarkimin e naftës/gazoilut – Stacioni i kaldajës së avullit, ADR 1. Të gjitha veprimet e drejtuesit të automjetit për shkarkimin e naftës kryhen nën kontrollin e drejtpërdrejtë të Montuesit, Operatorit të pajisjeve energjetike; 2. Tokëzimi bëhet me një kablo vertikale tokëzuese të autobotit, duke e lidhur vendin përkatës/pllakën e autobotit me tokëzuesin. 3. Zorra lëvizëse për shkarkimin e karburantit dizel kapet me majën e autobotit dhe me majën e linjës për mbushjen e rezervuarit; 4. Hap valvulën e autobotit për shkarkimin e karburantit 5. Ndez pompën për shkarkimin e autobotit; 6. Pas përfundimit të shkarkimit fik pompën, mbyll valvulat e autobotit dhe shkëput zorrët nga rakordet dhe nga kabloja e tokëzimit; 7. Shoferi i dorëzon të gjitha dokumentet e nevojshme Montuesit, operatorit të pajisjeve energjetike – dokumentin tatimor të akcizës, fletëngarkesa, certifikata e cilësisë, protokollin për markimin e naftës etj.; 8. Shoferi largohet nga sheshi dhe e çon autobotin për matje në peshoren e automjeteve;
H	EKOLOGJIA
H1	Terminal për ngarkim/shkarkim në Depo № 1
VP dhe PMP	1. Veshje pune, xhakëtë dhe kominoshe me rripa ose kominoshe, ose pantallona – sipas SSHB EN 13688:2013 2. Këpucë pune me majë mbrojtëse dhe me taban anti-shpim – sipas SSHB EN 20345:2011 S3 3. Jelek reflektues/ Veshje pune reflektuese 4. Helmetë siguroese me mbrojtje kundër goditjeve dhe rrymës elektrike – sipas SSHB EN 397:2012 + SSHB EN 50365:2003 5. Gjysmë-maskë me filtër ABE1P3 - sipas SSHB EN 14387:2004+A1:2008 + SSHB EN 143:2002 6. Syze sigurie me mbrojtje mekanike – sipas SSHB EN 166:1FT 7. Doreza sigurie me mbrojtje mekanike – sipas SSHB EN 388:2016
I	LABORATORËT ANALITIKË
I1	Terminal për shkarkimin e acetilenit, ADR
I2	Terminal për shkarkimin e argonit të lëngshëm në enë kriogjene, ADR
VP dhe PMP	1. Veshje pune, xhakëtë dhe kominoshe me rripa ose kominoshe, ose pantallona – sipas SSHB EN 13688:2013 2. Këpucë pune me majë mbrojtëse dhe me taban anti-shpim – sipas SSHB EN 20345:2011 S3

	3. Jelek reflektues/ Veshje pune reflektuese 4. Helmetë siguruese me mbrojtjes kundër goditjeve dhe rrymës elektrike – sipas SSHB EN 397:2012 + SSHB EN 50365:2003 5. Gjysmë-maskë me filtër ABE1P3 - sipas SSHB EN 14387:2004+A1:2008 + SSHB EN 143:2002 6. Syze sigurie me mbrojtje mekanike – sipas SSHB EN 166:1FT 7. Doreza sigurie me mbrojtje mekanike – sipas SSHB EN 388:2016
Terminal	RREGULLAT SPECIFIKE PËR NGARKIM/SHKARKIM
I2	Terminal për shkarkimin e argonit të lëngshëm në enë kriogjene, ADR Shoferi përgjigjet për shkarkimin e drejtë dhe të sigurt të argonit të lëngshëm në enë kriogjene, duke zbatuar këto veprime: 1. Shoferi hap valvulën V21 të enës kriogjene, për të lëshuar presionin. 2. Hap valvulat V1 dhe V2. 3. Hap ngadalë valvulën e daljes së autobotit. 4. Hap valvulën për rritjen e presionit në autobot duke ndjekur me manometër që presioni të mos kalojë pikën e treguar me markerin. 5. Kur presion arrin presionin e punës të enës kriogjene, mbyllet valvula për rritjen e presionit në autobot. 6. Fillon mbushja dhe me kujdes ndiqet manometri për presionin dhe matësin e nivelit të enës kriogjene. 7. Pasi fillon rrjedhja e lëngut përmes valvulës për kontroll vizual V21, mbyllet valvula e rrjedhjes të autobotit dhe valvula V21. 8. Mbyllen valvulat V1 dhe V2. 9. Hapet valvula e kullimit të autobotit që mbushet. 10. Pas kullimit të gjithë së tërë produktit përmes tubit fleksibël lidhës, ai shkëputet nga ena kriogjene. 11. Shefi i turnit dhe përgjegjësi për siguri në punë përgjigjen për monitorimin e veprimeve për shkarkimin e argonit të lëngshëm në enë kriogjene.
J	TERMINAL MENSA
J1	Terminal për ngarkim dhe shkarkim në Mensë № 1
VP dhe PMP	1. Veshje pune, xhaketë dhe kominoshe me rripa ose kominoshe, ose pantallona – sipas SSHB EN 13688:2013 2. Këpucë pune me majë mbrojtëse dhe me taban anti-shpim – sipas SSHB EN 20345:2011 S3 3. Jelek reflektues/ Veshje pune reflektuese 4. Doreza sigurie për mbrojtje mekanike – sipas SSHB EN 388:2016
K	M-TRANS EOOD /SHPK/
K1	Terminal për furnizimin e karburantit –Pika e karburantit, ADR
VP dhe PMP	1. Veshje pune, xhaketë dhe kominoshe me rripa ose kominoshe, ose pantallona – sipas SSHB EN EN 1149-1:2006 2. Këpucë pune me majë mbrojtëse dhe me taban anti-shpim – sipas SSHB EN 20345:2011 S3 3. Jelek reflektues/ Veshje pune reflektuese

	4. Helmetë siguroese me mbrojtjes kundër goditjeve dhe rrymës elektrike – sipas SSHB EN 397:2012 + SSHB EN 50365:2003 5. Syze sigurie me mbrojtje mekanike (të tipit të mbyllur) – sipas SSHB EN 166:2003 1FT ose mburoje mbrojtëse për fytyrë (transparente) sipas SSHB EN 166:2003 6. Doreza sigurie me mbrojtje mekanike dhe kimike – sipas SSHB EN 388:2016 + SSHB EN 374:2015
TERMINAL	RREGULLAT SPECIFIKE PËR NGARKIM/SHKARKIM
K1	Terminal për furnizimin e karburantit - Pika e karburantit, ADR Pritja dhe shkarkimi i autoboteve me naftë/diezel Drejtuesi i automjetit nën kontrollin e drejtpërdrejtë të përgjegjësit të pikës së karburantit të ndërmarrjes kryen operacionet për shkarkimin në këtë radhë: 1. Tokëzon autobotin me kablo të rregullt tokëzuese, duke lidhur vendin e caktuar të autobotit (plakën) me tokëzuesin; 2. Lidh zorrën lëvizëse të shkarkimit të naftës me rakordin e autobotit me rakordin e linjës për mbushjen e rezervuarit; 3. Hap valvulën për heqjen e ajrit të rezervuarit ose lidh një zorrë lëvizëse me rakordin e valvulës dhe me rakordin e autobotit; 4. Hap valvulën e autobotit për shkarkimin e naftës; 5. Shkarkimi është gravitacional; 6. Pas përfundimit të shkarkimit, mbyll valvulat e autobotit dhe shkëput zorrët nga rakordet dhe nga kabloja e tokëzimit; 7. Gjatë shkarkimit përgjegjësi i pikës së karburantit të ndërmarrjes kontrollon sasinë që shkarkohet me anën e numëruesve të autobotit. 8. Drejtuesi e automjetit mbyll valvulën e autobotit.
L	Magazina „LURGI“
L1	Terminal për shkarkimin në magazinën „Lurgi“
VP dhe PMP	1. Veshje pune, xhakëtë dhe kominoshe me rripa ose kominoshe ose pantallona - sipas SSHB EN 13688:2013 2. Këpucë pune me majë mbrojtëse dhe taban anti-shpim – sipas SSHB EN 20345:2011 S3 3. Jelek reflektuese/ veshje pune reflektuese 4. Helmetë siguroese, me mbrojtje kundër goditjeve dhe rrymës elektrike – sipas SSHB EN 397:2012 + SSHB EN 50365:2003 5. Syze sigurie me mbrojtje mekanike – sipas SSHB EN 166:2003 1FT 6. Doreza sigurie me mbrojtje mekanike – SSHB EN 388:2016